



## Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Odeljenje za Finansije i Budžet  
Department of Finance and Budget

### NJOFTIM PUBLIK

#### Nxjerrja e faturës, mënyra e pagesës dhe afati i pagesës së tatimit në pronë

Komuna e Rahovecit, njofton tatimpaguesit që janë të regjistruar në sistemin e tatimit në pronë me numra personalë të kartës së identifikimit së Republikës së Kosovës, që mund të nxjerrin faturën e tatimit në pronë drejtpërdrejt në platformën e-KOSOVA në linkun <https://ekosova.rks-gov.net/> ose duke u paraqitur personalisht në komunën ku edhe janë pronarë/e ose posedues/e të pronës së paluajtshme.

Pagesa e tatimit në pronë mund të bëhet në:

- Në ndonjë nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
- Përmes e-banking;
- Përmes platformës e-Kosova;
- Në Postën e Kosovës apo në institucione të tjera të licencuara në Kosovë;
- Nëse nuk jetoni në Kosovë, shfrytëzoni alternativa të tjera të pagesës.

Gjithashtu, rikujtojmë të gjithë tatimpaguesit të cilët nuk e kanë bërë pagesën e tatimit në pronë, që pagesën ta bëni me kohë, në mënyrë që të shmangni llogaritjen e interesit dhe të gjobës.

Pagesa e tatimit në pronë për personat fizikë rezidentë (që kanë numër personal të kartës së identifikimit së Republikës së Kosovës), mund të bëhet në dy kështe të barabarta dhe atë:

- Kësti i parë mund të paguhet deri më 30 prill 2025, dhe
- Kësti i dytë mund të paguhet deri më 30 shtator 2025.

Për personat fizikë jorezidentë (pa numër personal të kartës së identifikimit së Republikës së Kosovës, ose me numër personal të një shteti tjetër të huaj), tatimi në pronë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator 2025.

Nëse pagesa nuk bëhet sipas afateve si më lart, pason llogaritja e gjobës dhe e interesit, si në vijim:

- Në shumën e tatimit të secilit kësht të papaguar, llogaritet një gjobë prej **10%**;
- Në shumën e tatimit të secilit kësht të papaguar, llogaritet interesi në baza mujore prej **0.65%**.